



**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve
Drejtoria e Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale**

STANDARDI I KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

“DIZENJIM MODE”

Niveli V në KSHK¹, referuar niveli V të KEK²

D1-V-25

Hartuar me mbështetjen e Projektit “Aftësi për Punë”, financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe zbatuar nga Swisscontact

Tiranë 2025

¹ Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

² Korniza Evropiane e Kualifikimeve

Përmbajtja	
Emërtimi i kualifikimit	4
Kodi.....	4
Kohëzgjatja	4
Niveli.....	4
Qëllimi	4
Kriteret e përgjithshme të pranimiit	4
Mundësitë e kualifikimit të mëtjshëm dhe të punësimiit	4
Data e validimit.....	Error! Bookmark not defined.
Data e miratimiit	4
Variantet e mëparshme	4
STRUKTURA E KUALIFIKIMIT.....	5
KOMPETENCA TË PËRGJITHSHME.....	5
NJËSITË E TË NXËNIT TË KUALIFIKIMIT PROFESIONAL:	5
NjN-04-V-0311-25 Mjetet e punës dhe materialet për dizenjim mode	6
Rezultatet e të nxëniit në njohuri	6
Rezultatet e të nxëniit në shprehi profesionale	6
Kriteret e vlerësimiit	6
NjN-04-V-0312-25 Planifikimi dhe organizimi i punës në dizenjim mode	7
Rezultatet e të nxëniit në njohuri	7
Rezultatet e të nxëniit në shprehi profesionale	7
Kriteret e vlerësimiit	8
NjN-04-V-0313-25 Hulumtimi dhe frymëzimi për dizajnin.....	8
Rezultatet e të nxëniit në njohuri	8
Rezultatet e të nxëniit në shprehi profesionale	9
Kriteret e vlerësimiit	9
NjN-04-V-0314-25 Skicimi dhe zhvillimi i modelit	10
Rezultatet e të nxëniit në njohuri	10
Rezultatet e të nxëniit në shprehi profesionale	10
Kriteret e vlerësimiit	11
NjN-04-V-0315-25 Procesi i krijimit të produkteve të modës.....	11
Rezultatet e të nxëniit në njohuri	11
Rezultatet e të nxëniit në shprehi profesionale	12
Kriteret e vlerësimiit	12
NjN-23-V-0111-24 Sipërmarrje dhe edukim karriere.....	12
Rezultatet e të nxëniit në njohuri	12
Rezultatet e të nxëniit në shprehi profesionale	13
Kriteret e vlerësimiit	14
NjN-22-V-0130-24 Komunikimi dhe etika profesionale.....	14
Rezultatet e të nxëniit në njohuri	14
	2

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	15
Kriteret e vlerësimit	15
NjN-04-V-0316-25 Siguria në punë dhe mbrojtja e mjedisit në dizenjim mode	15
Rezultatet e të nxënit në njohuri	15
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	16
Kriteret e vlerësimit	16
Njësitë e të nxënit, peshat dhe kodet përkatëse:	17
Modalitetet e vlerësimit	17
Informacion shtesë	18
SHËNIM	18

Emërtimi i kualifikimit	DIZENJIM MODE		Kodi
Kohëzgjatja	2200-3000 orë nacionale	Niveli V në KSHK, referuar niveli V të KEK	D1-V-25
Qëllimi:	Qëllimi kryesor i kualifikimit profesional “Dizenjim mode”, niveli V në KSHK, referuar niveli V të KEK, është të përgatisë krijues të kualifikuar në fushën e modës të aftë për t’u punësuar në veprimtaritë profesionale që lidhen drejtpërdrejt me krijimin, prodhimin dhe konfeksionimin e produkteve të modës, si dhe të zhvillojë jo vetëm personalitetin krijues, por edhe personalitetin e tyre si qytetarë në përshtatje me mjedisin që i rrethon.		
Kriteret e përgjithshme të pranimit:	Në institucionet që ofrohet kualifikimi profesional në “Dizenjim mode”, niveli V në KSHK, referuar niveli V të KEK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë individët që: - Kanë përfunduar të paktën një kualifikim të nivelit IV në KSHK, referuar nivelit IV në KEK (arsimi i përgjithshëm, i mesëm artistik); - Janë në kushte shëndetësore që të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional; - pranohen edhe individë që kanë aftësi ndryshe, për të cilët ofruesi i kualifikimit krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me aftësitë që shfaqin.		
Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit:	Përfundimi me sukses i kualifikimit profesional në “Dizenjim mode”, niveli V në KSHK, referuar niveli V të KEK, e pajis individin me Certifikatën Profesionale dhe Suplementin përkatës, në këtë fushë, e cila njihet në territorin e Republikës së Shqipërisë. Ky arsimim i jep mundësi individit t’i drejtohet tregut të punës në ndërmarrje të ndryshme të prodhimit të produkteve të modës, atelie mode apo dhe të vetëpunësohet në sipërmarrje private. Individët mund të vazhdojnë studimet universitare, në fushën e modës dhe dizajnit.		
Ofruesi	<i>Ky kualifikim duhet të ofrohet nga ofrues të akredituar në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi për arsimin dhe formimin profesional.</i>		
Data e validimit	<i>Qershor 2025</i>		
Data miratimit			
Variantet mëparshme	D1-V-14		

STRUKTURA E KUALIFIKIMIT

Në përfundim të kualifikimit profesional “Dizenjm mode”, niveli V në KSHK, referuar nivelit V të KEK, individit duhet të zotërojë njohuritë, shprehjet profesionale dhe kompetencat e përgjithshme të ndara sipas njësive të të nxënimit të mëposhtme:

KOMPETENCA TË PËRGJITHSHME

Rezultatet e të nxënimit të kompetencave të përgjithshme janë të vlefshme për të gjitha njësitë e të nxënimit.

1. Të llogarisë me saktësi rezultatet e analizave duke përdorur aftësitë matematikore;
2. Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme;
3. Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional;
4. Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më eficiente;
5. Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror;
6. Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale;
7. Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij;
8. Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij;
9. Të organizojë drejt procesin e të nxënimit të tij dhe të shfaqë gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës;
10. Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar;
11. Të vlerësojë dhe vetëvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij;
12. Të demonstrojë sjellje dhe qëndrime etike në veprimtaritë shkollore dhe në komunitet;
13. Të demonstrojë aftësinë për të pranuar dhe promovuar ndryshimin dhe inovacionin;
14. Të demonstrojë aftësinë për të komunikuar dhe negociuar idetë në mënyrë eficiente me të tjerët;
15. Të demonstrojë aftësinë për të menduar në mënyrë krijuese dhe novatore;
16. Të demonstrojë aftësinë për të identifikuar dhe për të zgjidhur në mënyrë krijuese problemet.

NJËSITË E TË NXËNIMIT TË KUALIFIKIMIT PROFESIONAL:

Standardet e kualifikimit hartohen në bazë të rezultateve të të nxënimit (kompetenca të përgjithshme, njohuri dhe shprehje profesionale).

NjN-04-V-0311-25 Mjetet e punës dhe materialet për dizenjim mode

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë llojet e mjeteve dhe materialeve tradicionale dhe moderne të përdorura në dizajnin e modës sipas funksionit dhe përdorimit të tyre;
2. Të shpjegojë llojet e pajisjeve manuale dhe digjitale sipas funksionit dhe përdorimit të tyre;
3. Të argumentojë rëndësinë e përdorimit të teknikave grafike manuale dhe digjitale për procesin e krijimit;
4. Të shpjegojë rëndësinë e integritetit të teknologjisë digjitale në procesin kreativ, teknik dhe funksional të krijimit të produkteve të modës;
5. Të shpjegojë rëndësinë e mirëmbajtjes dhe pastrimit të mjeteve dhe materialeve sipas standardeve të sigurisë dhe higjienës;
6. Të shpjegojë rëndësinë e përzgjedhjes së saktë të materialeve për dizajnin e një produkti mode;
7. Të klasifikojë llojet e materialeve tekstile sipas origjinës;
8. Të shpjegojë llojet e tekstileve organike dhe karakteristikat e tyre;
9. Të shpjegojë llojet e lëkurave dhe gëzofeve;
10. Të analizojë karakteristikat themelore të materialeve tekstile;
11. Të shpjegojë proceset përfundimtare të tekstileve;
12. Të interpretojë etiketat dhe simbolikën për përbërjen dhe mirëmbajtjen e materialeve tekstile.
13. Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të terminologjisë teknike për të përshkruar mjetet dhe materialet e punës në industrinë e modës.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të përdorë mjetet, pajisjet e punës, si dhe teknikat grafike manuale dhe digjitale;
2. Të përdorë mjetet matëse dhe tabelat e përmasave;
3. Të menaxhojë/koordinojë veprimtarinë me makinat qepëse dhe pajisjet ndihmëse gjatë procesit të qepjes së produktit të modës;
4. Të përdorë materiale tekstile, lëkurë, gëzofë, si edhe materiale ndihmëse dhe zbukuruese, në përputhje me funksionin, sezonin dhe kërkesat estetike të produktit të modës;
5. Të kontrollojë mirëmbajtjen e mjeteve të punës dhe materialeve dhe sipas standardeve të higjienës dhe sigurisë;
6. Të përdorë teknika të thjeshta të manipulimit të tekstileve në përgatitjen e produkteve të modës;
7. Të përdorë informacionin e etiketës për të identifikuar përbërjen, mënyrën e mirëmbajtjes dhe përdorimit të materialeve gjatë procesit të punës.

Kriteret e vlerësimit

- Përdor saktë dhe në mënyrë të sigurt mjetet manuale të punës në proceset e dizenjimit;
- Përdor platforma digjitale në proceset e dizenjimit në mënyrë të saktë dhe krijuese;

- Mbikëqyr funksionalitetin dhe gatishmërinë e mjeteve/pajisjeve të punës, sipas kushteve teknike;
- Përdor saktë dhe në mënyrë të sigurt makineritë e punës në proceset e dizenjimit;
- Përdor metoda organoleptike për të dalluar saktësisht llojin e materialit tekstil;
- Përcakton materiale të përshtatshme sipas kërkesave funksionale dhe estetike të produktit të modës;
- Përdor informacionin e etiketës për të përzgjedhur ose trajtuar materialin në përputhje me kërkesat teknike;
- Krijon një moodboard (tabela e skicave) manual dhe digjital që përfshin materialet e përzgjedhura, ngjyrat dhe teksturat për modelin, koleksionin;
- Përdor materiale teknologjike të reja që janë në trend në industrinë e modës në përputhje me vetitë funksionale dhe estetike të produktit.

NjN-04-V-0312-25 Planifikimi dhe organizimi i punës në dizenjim mode

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë mënyrat e organizimit të një studio të krijimit të produkteve të modës;
2. Të përshkruajë strukturën organizative të një studio të krijimit të produkteve të modës;
3. Të analizojë llojet e koleksioneve dhe elementet e një koleksioni;
4. Të shpjegojë elementet përbërës të veshjes/produktit;
5. Të analizojë proceset e punës dhe kohën e realizimit të tyre;
6. Të argumentojë rëndësinë e radhës së punës në dizenjim mode;
7. Të argumentojë rëndësinë e planifikimit të burimeve njerëzore;
8. Të argumentojë rëndësinë e ndarjes së detyrave në ekip;
9. Të analizojë rëndësinë e organizimit të vendit të punës në mënyrë ergonomike;
10. Të shpjegojë rëndësinë e mbikëqyrjes së pastrimit dhe sistemimit të vendit të punës;
11. Të analizojë format dhe rëndësinë e bashkëpunimit me specialistë të tjerë;
12. Të analizojë format e dokumentimit dhe raportimit për bazën materiale dhe punën e kryer.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të analizojë porosinë, në mënyrë të qartë dhe të plotë, për realizimin e produkteve të modës;
2. Të hartojë planin e koleksionit, veshjes ose produktit në përputhje me tendencat aktuale të modës;
3. Të përcaktojë proceset e punës sipas llojit të veshjes /produktit;
4. Të menaxhojë burimet njerëzore në funksion të kërkesave të projektit dhe objektivave të punës;
5. Të menaxhojë kohën dhe radhën e punës, për të siguruar rrjedhshmëri dhe produktivitet;
6. Të ndajë detyrat mes anëtarëve të ekipit në bazë të aftësive dhe kompetencave përkatëse;
7. Të mbikëqyrë organizimin ergonomik dhe funksional të hapësirës së punës;

8. Të mbikëqyrë pastërtinë dhe rregullin e vazhdueshëm të vendit të punës gjatë gjithë procesit;
9. Të bashkëpunojë në mënyrë efektive me kolegë dhe specialistë të tjerë për arritjen e qëllimeve të përbashkëta;
10. Të dokumentojë dhe raportojë me saktësi procesin e punës në formatet përkatëse.

Kriteret e vlerësimit

- Merr porosinë sipas kërkesave;
- Planifikon koleksionin/veshjen/produktin, sipas kërkesës;
- Analizon porosinë sipas prioriteteve;
- Përcakton proceset e punës sipas llojit të veshjes /produktit;
- Planifikon radhën dhe kohën e punës, sipas proceseve;
- Mbikëqyr zbatimin e radhës së punës sipas proceseve;
- Mbikëqyr zbatimin e kohës së punës, sipas proceseve të skedës teknike;
- Menaxhon burimet materiale sipas kërkesë/ofertës në mënyrë efikase;
- Planifikon burimet njerëzore të nevojshme, sipas kërkesave dhe profileve teknike;
- Menaxhon burimet njerëzore të nevojshme duke ndarë detyrat, sipas kualifikimit dhe proceseve të punës;
- Mbikëqyr organizimin e vendit të punës në mënyrë ergonomike;
- Mbikëqyr pastrimin dhe sistemimin e vendit të punës, sipas kushteve teknike;
- Bashkëpunon me kolegë/specialistë të tjerë, sipas rregullores së brendshme;
- Mbikëqyr dokumentimin e punës së kryer sipas standardeve dhe formateve;
- Raporton rregullisht tek eprori/kolegët etj. sipas formateve përkatëse.

NjN-04-V-0313-25 Hulumtimi dhe frymëzimi për dizajnin

Rezultatet e të nxënit në njohuri

- Të analizojë llojet e burimeve të informacionit për krijimin e dizajnit;
- Të shpjegojë rëndësinë e rolit të demografisë dhe segmentimit të tregut;
- Të shpjegojë rëndësinë e njohjes së psikologjisë, nevojave dhe kërkesave të klientëve;
- Të analizojë ndikimin e periudhave të ndryshme stilistike;
- Të analizojë rëndësinë e njohjes së zhvillimit të tekstileve dhe të teknologjisë;
- Të përshkruajë trendet e modës dhe ciklet e tyre;
- Të analizojë siluetat, stilet, proporcionet dhe linjat në dizajn mode;
- Të përshkruajë rëndësinë e ndikimit të burimeve të ndryshme të informacionit, shtëpive të modës, si dhe dizajnerëve të ndryshëm;
- Të shpjegojë ndikimin e influencave dhe mediave sociale në dizajn mode;
- Të shpjegojë fazat e krijimit të një koncepti dizajni;
- Të analizojë rëndësinë e veshjeve, simboleve dhe ornamenteve tradicionale shqiptare;

- Të shpjegojë rëndësinë e arteve dhe zejeve shqiptare;
- Të shpjegojë rëndësinë e etnografisë dhe folklorit shqiptar;
- Të shpjegojë rëndësinë e ndikimit të globalizmit në modë;
- Të përshkruajë llojet e fibrave, fijeve dhe pëlhurave;
- Të përshkruajë rëndësinë e ndikimi të teksturës dhe ngjyrës në dizajn mode;
- Të shpjegojë mënyrat e kategorizimit të informacionit mbi hulumtimin dhe frymëzimin;
- Të shpjegojë rëndësinë e përzgjedhjes së informacioneve në vendimmarrje.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të përzgjedhë elementë nga trendet aktuale dhe të ardhshme të modës për të zhvilluar ide krijuese që i përgjigjen tregut;
2. Të përzgjedhë elemente nga historia, arti dhe kultura shqiptare për të krijuar dizajne frymëzuese;
3. Të përdorë informacione dhe të dhëna nga burime të ndryshme për të përcaktuar nevojat dhe preferencat në funksion të tregut, si dhe për krijimin e koleksionit;
4. Të krahasojë faktorët ekonomikë për të vlerësuar ndikimin e tyre në konsumin dhe përzgjedhjen e materialeve;
5. Të përzgjedhë tekstile moderne sipas karakteristikave dhe përshtatshmërisë për dizajn;
6. Të përdorë mjete digjitale dhe teknika kategorizimi për të strukturuar të dhënat e hulumtimit;
7. Të filtrojë informacionin e përzgjedhur për të ndihmuar në vendimmarrjen krijuese;
8. Të zhvillojë ide dizajni moderne duke u bazuar në elemente të trashëgimisë kulturore shqiptare, siluetat, proporcionet, ngjyrat, teksturat dhe njohuritë mbi periudhat stilistike dhe ciklet e modës;
9. Të krijojë një koncept të qartë dizajni për një koleksion ose produkt mode, bazuar në hulumtim.

Kriteret e vlerësimit

- Analizon trendet globale të modës për të identifikuar prirjet e reja të tregut në fushën e modës, sipas kërkesës;
- Analizon saktë ndikimin e historisë, artit dhe kulturës shqiptare në zhvillimin e ideve krijuese;
- Analizon periodikisht sjelljet e konsumatorit për të përcaktuar faktorët që ndikojnë në vendimmarrjen e blerjes;
- Hulumton mbi karakteristikat e tekstileve moderne sipas trendeve;
- Vlerëson përshtatshmërinë e tekstileve të përzgjedhura për realizimin e porosisë/koleksionit;
- Organizon informacione e mbledhur sipas burimeve dhe temave që do të përdoret në procesin e dizenjimit;
- Identifikon/klasifikon burimet e informacionit në funksion të kërkimeve të modës;
- Analizon ndikimin e periudhave të modës në krijimin e koleksioneve bashkëkohore;

- Përzgjedh informacione nga trendet dhe ciklet e modës në krijimin e koleksioneve bashkëkohore dhe ide kreative;
- Përzgjedh elementet tradicionale shqiptare (veshjet, simbolet, zejet) për t'i përdorur në dizajne moderne;
- Zbaton teknika të kategorizimit dhe përzgjedhjes së të dhënave përmes mjeteve digjitale për vendimmarrje të bazuar në fakte.

NjN-04-V-0314-25 Skicimi dhe zhvillimi i modelit

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë teknikat e ndërtimit të elementëve në vizatim;
2. Të analizojë anatominë e trupit të njeriut;
3. Të shpjegojë ndarjen e raporteve proporcionale në skicim;
4. Të përshkruajë llojet e siluetave të veshjeve;
5. Të shpjegojë teknikat e dizenjimit të siluetave;
6. Të shpjegojë rëndësinë e teorisë së ngjyrave për realizimin e skicës;
7. Të shpjegojë teknikat e krijimit të skicave;
8. Të shpjegojë rëndësinë e saktësisë së elementëve të skicës;
9. Të shpjegojë krijimin e koleksionit vizual dhe mënyrën e paraqitjes së tij;
10. Të shpjegojë llojet e testeve të tekstileve dhe rëndësinë e tyre;
11. Të shpjegojë teknikat e ndërtimit të prototipit;
12. Të përshkruajë mënyrat e testimit të prototipit;
13. Të analizojë teknikat e krijimit të formave dhe strukturave unike;
14. Të shpjegojë teknikat e manipulimit për të krijuar tekstura dhe efekte unike;
15. Të analizojë karakteristikat e qëndrimit në trup të tekstileve, lëkurave dhe gëzofëve;
16. Të argumentojë përshtatjen e karakteristikave të materialit me modelin.

Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale

1. Të përdorë teknika të ndryshme vizatimi për dizenjimin e produkteve të modës;
2. Të përdorë raportet proporcionale dhe anatominë e trupit gjatë skicimit të produkteve të modës;
3. Të krijojë dizajne të produkteve të modës duke përdorur teknika të ndryshme dizenjimi;
4. Të përdorë teorinë e ngjyrave në realizimin e dizajneve të ndryshme;
5. Të realizojë me saktësi skicën dhe elementët e saj duke përdorur ngjyra në realizimin e dizajnit;
6. Të krijojë dhe prezantojë koleksionin vizual;
7. Të kryejë teste të ndryshme në varësi të llojit të tekstilit;
8. Të ndërtojë prototipin e produkteve të dizenuara me mënyra të ndryshme;
9. Të përshtatë materialin me modelin e ideuar.

Kriteret e vlerësimit

- Përcakton teknikën e vizatimit në varësi të karakteristikave të stilit dhe strategjisë së zhvillimit të modelit;
- Ilustron idetë sipas tematikës së përzgjedhur;
- Përzgjedh skicat duke u bazuar në idetë më origjinale, funksionale dhe inovative;
- Zhvillon skicat në përshtatje me tematikën e planifikuar;
- Krijon një koleksion ngjyrash në përshtatje me trendet aktuale;
- Krijon koleksionin vizual në mënyrë të strukturuar për paraqitjen e tij;
- Teston mostra të tekstileve duke përdorur metoda të ndryshme;
- Përzgjedh tekstilet në përshtatje me cilësinë dhe kërkesat teknike të nevojshme për realizimin e produktit;
- Përzgjedh teknikën e përpunimit të tekstilit për të krijuar efektin dhe teksturën e dëshiruar;
- Ndërton prototipin e produktit sipas teknikave të ndryshme;
- Teston prototipin në përshtatje me kushtet e qëndrimit në trup të tekstilit;
- Përshtat materialin me modelin e skicuar duke u bazuar në karakteristikat fizike të tekstileve.

NjN-04-V-0315-25 Procesi i krijimit të produkteve të modës

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të argumentojë rëndësinë e njohjes së përmasave antropometrike;
2. Të klasifikojë llojet e produkteve të modës;
3. Të shpjegojë llojet e elementëve të produkteve të modës;
4. Të shpjegojë llojet e dekolteve;
5. Të përshkruajë llojet e pencave dhe funksionet e tyre;
6. Të shpjegojë teknikat e manipulimit të pencave;
7. Të interpretojë elementët e zbërthimit teknik të skicave;
8. Të shpjegojë ndërtimin e kallëpeve të elementeve të produkteve të modës;
9. Të përshkruajë mënyrat e përdorimit të teknikave manuale ose digjitale të ndërtimit të kallëpeve;
10. Të shpjegojë teknikat e prerjes;
11. Të shpjegojë teknikat e qepjes;
12. Të argumentojë rëndësinë e qëndrimit të veshjes dhe aksesorëve në trup;
13. Të përshkruajë llojet e defekteve të produktit të modës;
14. Të përshkruajë teknikat e korrigjimit të defekteve të produktit të modës;
15. Të shpjegojë mënyrat dhe rëndësinë e ekonomizimit të materialeve;
16. Të shpjegojë rëndësinë e paraqitjes fotografike në fushën e modës.
17. Të shpjegojë rëndësinë e ciklit të jetës së një produkti.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të mbikëqyrë realizimin e produkteve të modës, sipas dizajnit të koleksionit;
2. Të verifikojë përshtatjen e produkteve të modës sipas llojit;
3. Të verifikojë defektet dhe korrigjimin e tyre;
4. Të mbikëqyrë ekonomizimin e materialit në procesin e realizimit të produktit.

Kriteret e vlerësimit

- Analizon përmasat antropometrike sipas porosisë;
- Vlerëson proporcionet dhe raportet për zbërthimin teknik të skicës duke bashkëpunuar me modelistin;
- Mbikëqyr konfeksionimit e produkteve/veshjeve duke bashkëpunuar me rrobaqepësin;
- Mbikëqyr zbërthimin teknik të elementëve të skicës, sipas modelit;
- Mbikëqyr përdorimin e programeve kompjuterike për dizenjimin e veshjes/produktit;
- Bashkëpunon për ekonomizimit të materialit tekstil gjatë programimit kompjuterik ose manual;
- Mbikëqyr testimin e prototipit të qepur/veshur/realizuar sipas parametrave përkatëse;
- Bashkëpunon me modelistin për korrigjimin e prototipit sipas vizionit të koleksionit.
- Mbikëqyr procesin e prerjes sipas teknikave përkatëse;
- Mbikëqyr procesin e qepjes sipas teknikave përkatëse;
- Evidenton saktë defektet e produktit të modës;
- Mbikëqyr korrigjimin e defekteve të produktit të modës sipas rregullit;
- Kryen verifikimin e qëndrimit të veshjes në manekin ose në trup;
- Kryen verifikim e përshtatjes së aksesorëve ndihmës dhe zbukurues të rrobaqepësisë në prototip, sipas dizajnit;
- Kryen verifikim e përshtatjes së aksesorëve (çantë, kapele, rrip etj.), sipas dizajnit;
- Bashkëpunon me klientin për realizimin e veshjes/produktit individual sipas skicës fillestare dhe të dhënave të mbledhura;
- Bashkëpunon me fotografën për prezantimin e koleksionit në përshtatje me idenë e koleksionit/porosisë.

NjN-23-V-0111-24 Sipërmarrje dhe edukim karriere

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të përshkruajë funksionet administrative bazë në një atelie apo studio mode;
2. Të dallojë llojet kryesore të dokumentacioneve ligjore, teknike dhe financiare të nevojshme në sektorin e modës;
3. Të shpjegojë mënyrat e përpilimit dhe arkivimit të dokumenteve të punës në një atelie apo studio mode;
4. Të shpjegojë konceptet themelore të menaxhimit të projektit në fushën e dizajnit të modës;

5. Të përshkruajë mënyrën e llogaritjes së materialeve, mjeteve dhe kostove për një projekt mode;
6. Të përshkruajë rëndësinë e përgatitjes së një grafiku pune për realizimin e projektit;
7. Të shpjegojë hapat për përgatitjen e një oferte të thjeshtë për produkte apo shërbime të modës;
8. Të përshkruajë teknikat bazë të marketingut dhe mënyrat e promovimit në industrinë e modës;
9. Të përshkruajë rëndësinë e vlerësimit dhe motivimit të stafit;
10. Të shpjegojë mënyrat e mbledhjes së informacionit nga tregu për çmime, materiale dhe konkurrentë;
11. Të analizojë vetveten në funksion të zhvillimit profesional, përmes njohjes së aftësive dhe interesave personale;
12. Të përshkruajë metodat kryesore për përmirësimin e vazhdueshëm profesional në fushën e dizajnit të modës;
13. Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të literaturës dhe teknologjisë për përditësimin profesional;
14. Të rendisë format kryesore të sfilatave, ekspozitave dhe panaireve në industrinë e modës dhe qëllimin e tyre;
15. Të përshkruajë llojet e konkurseve kreative, dhe rolin që ato luajnë në promovimin e dizajnerëve të rinj;
16. Të shpjegojë mënyrat e përfshirjes në trajnime dhe kurse për zhvillimin profesional të dizajnerëve të modës.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të menaxhojë dokumentet ligjore, teknike dhe financiare në një atelie ose studio mode;
2. Të menaxhojë punën ditore, javore dhe mujore, duke përcaktuar hapat dhe kohëzgjatjen e secilit aktivitet;
3. Të menaxhojë të dhëna financiare, fatura, oferta, inventarizim të mjeteve dhe materialeve për projekte mode etj.;
4. Të kryejë llogaritje të nevojshme për materialet, mjetet, shërbimet, si dhe çmimin përfundimtar të një produkti apo shërbimi;
5. Të mbikëqyrë përgatitjen e dokumentit shoqërues të dorëzimit të produkteve dhe shërbimeve;
6. Të mbledhë informacion nga furnizues dhe tregu për çmime, cilësi dhe disponueshmëri të materialeve dhe pajisjeve;
7. Të menaxhojë fushata promovimi për produkte apo shërbime mode;
8. Të mbështesë motivimin dhe vlerësimin e ekipit të punës, përmes komunikimit dhe bashkëpunimit;
9. Të zgjedhë forma për trajnime dhe aktivitete profesionale për zhvillim të vazhduar

profesional.

Kriteret e vlerësimit

- Zbaton kuadrin ligjor në fuqi që rregullon veprimtarinë profesionale;
- Asiston në përgatitjen dhe sistemimin e dokumentacionit financiar, sipas formatit të përcaktuar;
- Bashkëpunon për hartimin e raporteve financiare, sipas formateve;
- Kryerjen saktë llogaritje paraprake për kostot e materialeve, mjeteve dhe shërbimeve sipas koleksionit/porosisë;
- Siguron të dhëna të sakta për përgatitjen e faturave dhe ofertave për produktet/shërbimet, sipas procedurës;
- Merr periodikisht informacion nga tregu lidhur me çmimet dhe cilësinë e mjeteve, materialeve dhe pajisjeve të punës;
- Asiston në llogaritjen e saktë të çmimit përfundimtar për produktet/shërbimet e ofruara;
- Mbikëqyr plotësimin e dokumentacionit për dorëzimin e produkteve/shërbimeve, sipas formatit;
- Ndjek procesin e inventarizimit sipas formatit;
- Motivon dhe vlerëson stafin, vazhdimisht;
- Bashkëpunon në zbatimin e teknikave të marketingut për produktet/shërbimet e ofruara;
- Përzgjedh metodat e zhvillimit profesional dhe të karrierës;
- Përditëson dhe transmeton në kohë tek bashkëpunëtorët njohuritë dhe teknikat e reja në punë;
- Ndjek aktivitete profesionale dhe trajnuese për përmirësimin e aftësive si trajnime, kurse teknike, panairë dhe ekspozita.

NjN-22-V-0130-24 Komunikimi dhe etika profesionale

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të analizojë metodat e informacionit për problemet dhe të rejat e ditës;
2. Të shpjegojë rëndësinë e komunikimi etik dhe profesional;
3. Të përshkruajë rregullat bazë të komunikimit verbal dhe jo verbal me eprorët, bashkëpunëtorët dhe klientët;
4. Të shpjegojë rëndësinë e parimeve të punës në grup;
5. Të analizojë rëndësinë e ndërveprimit me eprorë, bashkëpunëtorët dhe klientët në veprimtaritë profesionale;
6. Të argumentojë rëndësinë e respektimit të kodit të etikës;
7. Të shpjegojë rolin e bashkëpunëtorëve në veprimtarinë profesionale;
8. Të shpjegojë rëndësinë e menaxhimit të mendimit kritik;
9. Të argumentojë mënyrat e zgjidhjes së konflikteve dhe situatave të ndjeshme (klient/staf);

10. Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) në procesin e komunikimit me të tjerët;
11. Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të terminologjisë profesionale;
12. Të shpjegojë rëndësinë e respektimit të barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare etj.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të mbikëqyrë zbatimin e metodave të komunikimit verbal dhe joverbal duke përdorur TIK dhe terminologji profesionale;
2. Të përdorë metoda të ndryshme informacioni për zgjidhjen e problemeve;
3. Të komunikojë saktë dhe në mënyrë profesionale me klientët, bashkëpunëtorët etj.;
4. Të mbikëqyrë respektimin e parimeve të barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare.

Kriteret e vlerësimit

- Informohet periodikisht mbi problemet dhe të rejat e ditës;
- Mbikëqyr zbatimin e rregullave të komunikimit verbal dhe jo verbal;
- Mbikëqyr zbatimin e parimeve të punës në grup;
- Zbaton rregullat e komunikimit me eprorët/stafit dhe klientët;
- Merr dhe jep vendime sipas udhëzimeve nga bashkëpunëtorët për realizimin e detyrës duke përdorur terminologji të qartë;
- Zbaton teknologjitë e reja të komunikimit;
- Zgjidh ankesat dhe mosmarrëveshjet me eprorët/stafin dhe klientët;
- Ruan privatësinë e klientit/produktit, sipas parimeve të etikës;
- Përdor saktë terminologjinë profesionale;
- Vepron/Komunikon në përputhje me parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera.

NjN-04-V-0316-25 Siguria në punë dhe mbrojtja e mjedisit në dizenjim mode

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të përshkruajë standardet dhe legjislacionin shqiptar në fuqi për zbatimin e rregullave të sigurimit teknik;
2. Të argumentojë rëndësinë e përdorimit të manualeve të mjeteve e pajisjeve të punës;
3. Të shpjegojë mënyrat e dhënies së ndihmës së parë në rast aksidenti me mjetet përkatëse;
4. Të analizojë rëndësinë e interpretimit të sinjalistikave në mjedisin e punës;
5. Të përshkruajë procedurat e evakuimit për raste emergjence;

6. Të shpjegojë përdorimin e kutisë së MZSH³;
7. Të përshkruajë masat përkatëse gjatë përdorimit të solucionëve me përmbajtje kimike;
8. Të analizojë karakteristikat e një mjedisi të qëndrueshëm;
9. Të argumentojë rëndësinë e përdorimit të materialeve që kanë ndikim të ulët në mjedis;
10. Të analizojë masat përkatëse në raste të mosfunksionimit të mjeteve dhe pajisjeve të sigurisë;
11. Të përshkruajë mënyrat e mbikëqyrjes së zbatimit të procedurave për ndarjen e mbetjeve sipas llojit;
12. Të përshkruajë mënyrat e mbikëqyrjes së depozitimit të mbetjeve sipas rregulloreve të mjedisit;
13. Të përshkruajë mënyrat e mbikëqyrjes së ruajtjes dhe magazinimit të materialeve;
14. Të përshkruajë protokollet e duhura në raste të gjendjes së jashtëzakonshme.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të respektojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit në vendin e punës;
2. Të përdorë manualët përkatëse në përdorimin e mjeteve dhe pajisjeve të punës;
3. Të japë ndihmën e parë në rast aksidenti;
4. Të respektojë sinjalistikën në mjediset e punës sipas rregullores së brendshme;
5. Të zbatojë planin e evakuimit në raste emergjence sipas procedurës respektive;
6. Të zbatojë rregullat e shpëtimit dhe mbrojtjes ndaj zjarrit sipas rregullores përkatëse;
7. Të zbatojë rregulloret përkatëse gjatë përdorimit të solucionëve me përmbajtje kimike sipas llojit;
8. Të marrë masa në kohën e duhur në rast të mosfunksionimit të mjeteve dhe pajisjeve të sigurisë;
9. Të mbikëqyrë zbatimin e procedurave për ndarjen e mbetjeve dhe depozitimin e tyre;
10. Të mbikëqyrë ruajtjen dhe magazinimin e materialeve në përputhje me udhëzimet përkatëse në mënyrë që të mos rrezikojë ndotjen e mjedisit;
11. Të përdorë në mënyrë racionale energjinë dhe materialet, si dhe të zbatojë parimet e zhvillimit të qëndrueshëm të mjedisit;
12. Të zbatojë në mënyrë rigoroze protokollet e duhura në raste të gjendjes së jashtëzakonshme.

Kriteret e vlerësimit

- Respekton standardet dhe legjislacionin në fuqi për sigurimin teknik dhe mbrojtjen e mjedisit;
- Përdor manualët e mjeteve dhe pajisjeve të punës sipas udhëzimeve teknike;
- Zbaton procedurat e dhënies së ndihmës së parë dhe përdor mjetet përkatëse në rast aksidenti;
- Respekton sinjalistikën në mjedisin e punës;

³ Mbrojtja nga zjarri dhe shpëtimi

- Zbaton procedurat e evakuimit për raste emergjente;
- Përdor pajisjet dhe materialet e kutisë së MZSH;
- Mbikëqyr zbatimin e masave mbrojtëse gjatë përdorimit të solucioneve me përmbajtje kimike;
- Merr masa të përshtatshme në rast të mosfunksionimit të mjeteve dhe pajisjeve të sigurisë;
- Identifikon karakteristikat e një mjedisi të qëndrueshëm;
- Identifikon materialet që kanë ndikim të ulët në mjedis;
- Aplikon parimet e ruajtjes së një mjedisi të qëndrueshëm;
- Mbikëqyr ndarjen e mbetjeve sipas llojit dhe kontrollon respektimin e procedurave përkatëse;
- Mbikëqyr depozitimin e mbetjeve në përputhje me rregullat për mbrojtjen e mjedisit;
- Mbikëqyr zbatimin e rregullave për ruajtjen dhe magazinimin e materialeve që paraqesin rrezik për ndotjen e mjedisit;
- Zbaton protokollet për raste të gjendjes së jashtëzakonshme në mënyrë të sigurt dhe efikase.

Njësitë e të nxënit, peshat dhe kodet përkatëse:

Nr.	Njësi të nxëni	Peshat në %	Kodet
1	Mjetet e punës dhe materialet për dizajnim mode	6	NjN-04-V-0311-25
2	Planifikimi dhe organizimi i punës në dizajnim mode	10	NjN-04-V-0312-25
3	Hulumtimi dhe frymëzimi për dizajnin	15	NjN-04-V-0313-25
4	Skicimi dhe zhvillimi i modelit	18	NjN-04-V-0314-25
5	Procesi i krijimit të produkteve të modës	42	NjN-04-V-0315-25
6	Sipërmarrje dhe edukim karriere	3	NjN-23-V-0111-24
7	Komunikimi dhe etika profesionale	3	NjN-22-V-0130-24
8	Siguria në punë dhe mbrojtja e mjedisit në dizajnim mode	3	NjN-04-V-0316-25
	Total	100	

Modalitetet e vlerësimit

Me vlerësim kuptojmë procesin gjatë të cilit mblidhen të dhëna dhe gjykohet për vlerën e arritjes së një rezultati të nxëni (RN), mbi bazën e kriterëve të caktuar.

Për vlerësimin mund të përdoren një shumëllojshmëri metodash standarde dhe inovatore.

Individi i nënshtrohet vlerësimit të vazhduar, përmbledhës dhe vlerësimit përfundimtar për kualifikimet formale që ofrohen në ofrues të akredituar.

Individi vlerësohet për shkallën e përvetësimit të kompetencave të përgjithshme dhe profesionale, të nevojshme për të punuar në veprimtari të ndryshme profesionale që operojnë në fushën përkatëse dhe vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së RN për realizimin e tërësisë së proceseve duke mbajtur evidenca për qëllime dokumentimi.

Realizimi i pranueshëm do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të specifikuar. Dhënia e rezultatit të vlerësimit bëhet sipas kuadrit ligjor në fuqi.

Kompetencat e përgjithshme vlerësohen të integruara si pjesë e vlerësimit të njësive të të nxënit. Individi i lind e drejtë të certifikohet për njësitë të nxëni specifike, si një kualifikim i pjesshëm sipas kuadrit ligjor në fuqi.

Informacion shtesë

Kualifikimet e plota ose të pjesshme profesionale mund të përftohen nëpërmjet këtyre formave:

- a) ndjekjes së arsimit profesional me bazë shkollën;
- b) ndjekjes së kurseve profesionale, ku përfshihen edhe praktikat profesionale në ndërmarrje apo forma të tjera të mësimnxënies praktike;
- c) regjistrimit si nxënës, duke u punësuar në një ndërmarrje (forma e dyfishtë);
- ç) njohjes të të nxënit të mëparshëm informal dhe joformal;
- d) njohjes të të nxënit të përfutur jashtë vendit;
- dh) formave të tjera të përcaktuara me ligj.

SHËNIM

Shpjegime të kodit të kualifikimit: **D1-V-25**

D – Shkronja që identifikon fushën e kualifikimit profesional

1 – Numri që identifikon profilin/specializimin e kualifikimit përkatës

V – Shifra që identifikon nivelin sipas KSHK

25 – Shkurtimi i vitit kalendarik kur është hartuar/rishikuar kualifikimi profesional

Shpjegime të kodit të njësisë së të nxënit: **NjN-04-V-0311-25**

NjN – Shkronjat që tregojnë se kodi i referohet Njësive të të Nxënit

04 – Numri që identifikon fushën e Njësisë së të Nxënit

V – Shifra që tregon nivelin e Njësisë së të Nxënit në strukturën e KSHK

0311 – Numri rritës progresiv që tregon gjendjen e Njësive të të Nxënit në ditën e hartimit përkatës

25 – Shkurtimi i vitit kalendarik kur është hartuar/rishikuar Njësia e të Nxënit